



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:228492

Datë: 02.05.2024

Numri i dokumentit: 05647137

KPPP.nr. 1712/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit BP Consulting L.L.C., me numër unik identifikues 810099160 dhe me seli në Prishtinë, rr. "Ilaz Kodra", BL., nr. 5/7, H 4, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Florian Petani, avokat nga Prishtina, kundër debitorit "Risk Broker" Sh.P.K., me numër unik identifikues 810520793 dhe me seli në Prishtinë, rr. "Rexhep Luci", H24, nr. 1, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 214/2023 i datës 29.09.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Emine Sherifi Lubeniqi nga Prishtina, jashtë seancës me datën 02.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit "Risk Broker" Sh.P.K., ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 214/2023 i datës 29.09.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Emine Sherifi Lubeniqi, MBETET NË FUQI.
- II. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim, t'ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej EUR 78€.00 (shtatëdhjetë e tetë euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit BP Consulting L.L.C., me datë 29.09.2023 ka lëshuar urdhrin P.nr. 214/2023, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit Faturës nr. 2021/008, e datës 03.05.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin, në emër të borxhit sipas faturës së lartcekur t'ia

paguaj kreditorit shumën prej 500.00 EUR, me kamatë ligjore prej 8 %, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore dhe shpenzimet në emër të përfaqësimit sipas tarifës së OAK-së.

Debitori, brenda afatit ligjor ka parashtruar Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përbarimor me arsyetim se dokumenti në bazë të së cilit është marr vendimi ose urdhri përbarues nuk ka titull ekzekutiv ose tipare të përbarueshmërisë, ashtu që fatura i është dhënë në momentin e lidhjes së kontratës pa filluar zbatimin e saj, si dhe nuk dihet se mbi çfarë baze është lëshuar e njëjta. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit si të bazuar.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar në përgjigje në prapësim e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit me arsyetim se në propozimin për përbarim është bashkangjitur fatura e cila është lëshuar konform Marrëveshjes për shërbime këshilluese në fushën e prokurimit nr. 2021/002, e datës 30.04.2021, në mes kreditorit dhe debitorit. Ka shtuar se nga email-at e bashkangjitur propozimit për përbarim rezulton që ka kërkuar në vazhdimësi përmbushjen e detyrimit sipas faturës nga debitori, të cilin detyrim nuk e ka kontestuar asnjëherë. Duke qenë së fatura përbën dokument të besueshëm dhe si i tillë është e përshtatshme për përbarim konform nenit 29.3 të LPP-së, është e nënshkruar dhe vulosur nga debitori, nga ku rezulton se i njëjti ka pranuar në tërësi shërbimet e pranuar, si dhe kompensimin përkatës që derivon nga pranimi i shërbimeve të faturuara, për këto arsye i ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përbarimor të mbetet në fuqi, si dhe të detyrohet debitori që të kompensojë shumën prej 208.00 €, në emër të shpenzimeve të procedurës, sipas tarifës së OAK-së.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përbarim paraqitet*

në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Faturës nr. 2021/008, e datës 03.05.2021, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, Gjykata gjeti se fatura e lartcekur është pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit në faturë, dhe e njëjta i është bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si e tillë paraqet bazë për lejimin e përmbarimit pasi që është e përshtatshme për përmbarim.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbarim nuk përbën dokument të besueshëm, mirëpo gjeti se pretendimet e tilla janë të pa bazuara për faktin se në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë përshkruar shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi, ashtu siç përcaktohet me nenin 29 par. 3 të LPP-së, si dhe e njëjta është pranuar nga debitori, duke qenë se është nënshkruar dhe vulosur nga i njëjti. Andaj, pretendimet e tilla nuk paraqesin asnjë nga shkaqet e parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Lidhur me shpenzimet e procedurës përmbarimore gjykata vendosi në kuptim nenit 13 dhe 17 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet kreditorit në emër përgjigjes në prapësim të ushtruar, në vlerë prej EUR 78.00, konform tarifës së OAK, nr. tarifor 6, lidhur me përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm me vlerë deri në lartësinë e kontestit të vlerës së vogël.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1712/23, datë 02.05.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.